



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 651/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e organizatës joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, të paraqitura kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021, të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohen** të pabazuara ankesat: Anr.651/2021 dhe Anr.652/2021, të datës 18.10.2021, të paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, të paraqitura kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

### A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesat, Anr.651/2021 dhe Anr.652/2021 të datës 18.10.2021 të paraqitura nga organizata joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në të cilat pretendon se me datë 17.10.2021 kandidatët për kuvend komunal nga ky subjekt Plator Asllani dhe Ruzhdi Shehu nga Obiliqi kanë thyer heshtjen zgjedhore, ku me anë të rrjetit social Facebook kanë sponsorizuar postime me anë të të cilave kanë kërkuar nga qytetarët që ti votojnë të njëjtit. Këto postime të sponsorizuara u janë shfaqur përdoruesve të rrjetit social Facebook në ditën e zgjedhjeve dhe në këtë mënyrë konsiderojmë që ka ndikuar tek të njëjtit për mënyrën e votimit.

Ankesave u kanë bashkangjitur edhe fotografi si dëshmi.

Përgjigje në ankesa nuk ka paraqitur subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, edhe pse e njëjta është njoftuar me kërkesë për përgjigje në ankesë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesat janë të pabazuara**

Paneli, pasi ka vlerësuar pretendimet në ankesat Anr.651/2021 dhe Anr.652/2021 të datës 18.10.2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i ankesave është organizata joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik Lidhja Demokratike e Kosovës, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 18.10.2021 ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazura ngase nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse të njëjtat një ditë me parë kanë qenë aktive ndersa në kohën e testimit të njëjtat kane qene jo aktive.

Duke marrë parasysh të cekurat më lartë, Paneli vlerëson se parashtresë i ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar me datë 17.10.2021, e kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamat e shkelësve të supozuar janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit, edhe pse parashtresë i ankesës ka paraqitur fotografi me të cilat pretendon se postimet e sponsorizuara kanë qenë aktive në ditën e votimit, paneli këto pretendime nuk mundi ti vërtetoj sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave të shkelësve të supozuar siç pretendohet në ankesa.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.651/2021 më datën 20.10.2021



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.